

BULETINI



SHKURT 2024



Tryeza të rrumbullakëta në Prizren dhe Ferizaj

Në kuadër të projektit "Avancimi i të drejtave të njeriut përmes rritjes së vetëdijes publike", i zbatuar nga OJQ ACDC, dhe i mbështetur nga UNMIK-u, gjatë muajit shkurt, janë organizuar dy tryeza të rrumbullakëta në Ferizaj dhe Prizren.

Objektivi kryesor i këtyre takimeve ishte të diskutohet me Avokatin e Popullit z. Naim Qelaj, me komunitetet shumicë, si dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit dhe organizatave të shoqërisë civile në përpjekjet për të mbrojtur dhe avancuar liritë dhe të drejtat e njeriut.



Tryezë diskutimi me Policinë e Kosovës



Më 13 shkurt, OJQ ACDC organizoi një tryezë diskutimi në Mitrovicën e Veriut ndërmjet Policisë së Kosovës dhe komunitetit lokal.

Në këtë tryezë morën pjesë përfaqësues të policisë, të udhëhequr nga zëvendësudrejtori i Policisë së Kosovës për Rajonin Verior, Veton Elshani, si dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare, partive politike dhe qytetarë të tjerë. Kjo tryezë i lejoi pjesëmarrësit t'u drejtohen drejtpërdrejt përfaqësuesve të policisë dhe të shprehin shqetësimet, pyetjet dhe kritikën e tyre. Diskutimet e hapura mbuluan çështje dhe sfida të ndryshme në lidhje me punën e policisë në veri të Kosovës, duke përfshirë përmirësimin e bashkëpunimit, sqarimin e çështjeve ligjore dhe adresimin e sfidave specifike.

Ngjarja u organizua në kuadër të projektit "Rritja e transparencës dhe sundimit të ligjit në komunitetet shumicë serbe në Kosovë", financuar nga Byroja Ndërkombëtare e Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL).

Publikimi i OP-ED-ëve dhe Thirrja për Aplikime

OP-ED-ët e botuar në shkurt eksplorojnë gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë, duke u fokusuar në mbrojtjen e të drejtave të grave, luftën kundër diskriminimit në bazë gjinore dhe sundimin e ligjit.



SRB



ALB

Pas përfundimit me sukses të raundit të parë të trajnimit, ACDC publikoi një thirrje ku ftoi të gjithë të rinjtë e shkollave të mesme dhe universitetet (18-29 vjeç) të aplikojnë për raundin e dytë të trajnimit të aftësive të buta. Kjo thirrje është publikuar në kuadër të projektit të mbështetur nga GIZ.

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DSK), në bashkëpunim me OJQ ACDC, mbajtën një sesion informues më 27 shkurt në objektin e OJQ ACDC në Mitrovicën e Veriut. Sesioni kishte për qëllim rritjen e komunikimit me publikun dhe ofrimin e informatave të vlefshme për misionin e DSK-së, duke u fokusuar në procedurat ligjore lidhur me krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe veprat e tjera penale.



Diskutim publik: Nxitja e bashkëpunimit rinor nga komunitete të ndryshme

Më 22 shkurt 2024, OJQ ACDC, në partneritet me OJQ REC, organizoi diskutimin publik në Shtëpinë e BE-së në Mitrovicën e Veriut. Qëllimi i ngjarjes ishte të përmirësonte komunikimin dhe bashkëpunimin ndërmjet studentëve nga komunitete të ndryshme, të promovonte mirëkuptimin dhe respektin e ndërsjellë dhe të nënvizonte ndikimin pozitiv të nismave të tilla në shoqëri. Në diskutim morën pjesë z. Dushan Radakovic nga OJQ ACDC, z. Lulzim Hakaj nga OJQ REC, Velisa Vucurovic, i diplomuar në Drejtësi dhe Elmedina Kurti, Kryetare e Parlamentit Studentor të Universitetit "Isa Boletini" Mitrovicë. Ambasadori italian në Prishtinë, z. Antonello De Riu, mori pjesë në këtë aktivitet dhe shprehu kënaqësinë e madhe për organizimin e tij. Ambasadori De Riu tha se promovimi i bashkëpunimit ndërmjet të rinjve nga komunitete të ndryshme është thelbësor për ndërtimin e besimit dhe një vizion të përbashkët për të ardhmen.

Diskutimi publik u organizua në kuadër të projekti të zbatuar nga OJQ ACDC dhe OJQ REC, financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës Italiane.



Fillimi i një platforme të re për komunitetet në Kosovë




Më 28 shkurt, në Prishtinë u mbajt një konferencë për të nisur një platformë të re për komunitetet në Kosovë, e zhvilluar nga OJQ ACDC në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM) dhe e mbështetur nga Ambasada Britanike dhe Ambasada e Zvicrës, për nevojat të Zyrës për Çështje të Komuniteteve. Konferenca shfaqti burime të ndryshme të disponueshme në platformë, duke theksuar qasjen miqësore për përdoruesit dhe qasjen e lehtë dhe nënvizoi përfitimet e shumta që ajo ofron si për komunitetet ashtu edhe për organizatat që punojnë drejt përmirësimit të tyre.

Drejtori i Programit të ACDC, Aleksandar Rapajiq prezantoi platformën dhe përvijoi veçoritë kryesore të saj, duke përfshirë regjistrimin e OJQ-ve ose individëve që merren me probleme specifike të komunitetit, duke i lejuar ata të zgjedhin një komunitet prioritar dhe të fokusohen në zgjidhjen e problemeve specifike; informata për secilin komunitet në Kosovë; mekanizmi për raportimin e shkeljeve të të drejtave të komuniteteve; lajme për Zyrën për Komunitete, buletin, raporte, si dhe thirrje publike; disponueshmëria në gjashtë gjuhë për të adresuar çdo komunitet dhe informata të tjera të rëndësishme.

Platforma online, e zhvilluar në bashkëpunim me Zyrën për Çështje të Komuniteteve, paraqet një burim gjithëpërfshirës për komunitetet joshumicë në Kosovë. Është e disponueshme në gjashtë gjuhë, duke përfshirë gjuhën shqipe, serbe, rome, boshnjake, gorane dhe turke, si dhe synon të mobilizojë dhe organizojë qytetarët përmes planifikimit strategjik për të adresuar çështjet e komunitetit, duke përdorur platformën online, protesta, veprime krijuese, raportime dhe propozime për zgjidhjet përkatëse ligjore për zyrtarët përgjegjës.



<http://zck-kpz-platform.rks-gov.net>



Së bashku me OJQ Aktiv, Instituti për Zhvillim Ekonomik Territorial (INTER) dhe Nisma e Re Sociale, ACDC publikoi një komunikatë për media lidhur me deklaratat e bëra nga Albin Kurti dhe partia politike që ai drejton, Vetëvendosje.



Konferenca për shtyp nga Shoqëria Civile

Disa organizata të shoqërisë civile, duke përfshirë ACDC, mbajtën një konferencë për shtyp në Prishtinë më 8 shkurt për të paraqitur kërkesat kryesore për përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe komunitetit serb. Këto kërkesa fokusohen në zgjidhjen e statusit të Asociacionit të Komunave me shumicë serbe dhe sigurimin e transparencës dhe autenticitetit në dialogun ndërmjet qeverisë dhe komunitetit serb.

ACDC në Media

Dushan Radaković, Drejtor Ekzekutiv, në Kosovo Online për përdorimin e dinarit në Kosovë



Dushan Radaković, Drejtor Ekzekutiv, në Kosovo Online



Dushan Radaković, Drejtor Ekzekutiv, në Kosovo Online rreth procesit të shkarkimit të kryetarëve në veri të Kosovës



Aleksandar Rapajiq, Drejtor Programi, në N1 - Serbët në Kosovë: "Në letër" jetojnë në prosperitet, në realitet - të padukshëm



Aleksandar Rapajiq në Kosovo Online për sanksionet ndaj Kosovës



Aleksandar Rapajiq në Kosovo Online për negociatat në Bruksel



Aleksandar Rapajiq në Alternativa për heqjen e dinarit



Slobodan Stosic, Menaxher Programi, në Al Jazeera Balkans



Ines Aljovic Mihajlovic, Zyrtare Programi, në programin e mëngjesit në RTK2

